

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERVE TIRANE
Nr. 6340 Rep.
Nr. 1141 Kol.

PULLE TAKSE



KONTRATE SHITJE AKSIONESH

Sot, me daten 27.12.2005 (dymije e pese), para meje noterit Dusho Dusha, u paraqiten personalisht shitesi dhe bleresia te cilet kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitje aksionesh me termat e meposhteme :

SHITESI : Renis Tershana, i biri i Agimit, i datelindjes 23.09.1971, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te per te vepruar, identifikuar me pasaporten Nr.1244100, aksioner i shoqerise "BANKA CREDINS" sha,

BLERESE : Monika Milo, e bija e Kristaqit, e datelindjes 07.10.1967, identifikuar me pasaporten Nr.1629243, madhore, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, aksionere e shoqerise « BANKA CREDINS » sha,

OBJEKTI : Shitja e aksioneve te shoqerise "BANKA CREDINS" sha ne masen 3(tre) perqind nga ana e Renis Tershana dhe blerja e tyre nga Monika Milo.

PERMBAJTJA E KONTRATES

Shoqeria "BANKA CREDINS" sha eshte regjistruar ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane me vendimin Nr.28969, date 31.03.2003.

Shoqeria ka nje kapital themeltar te regjistruar (te paguar) prej 10.614.155 (dhjetemilion e gjashteqind e katermbedhjetemije e njeqind e pesedhjetë e pese) USD qe perfaqesojne 100 perqind te kapitalit aksioner, me vlere nominale te nje aksioni 1 (nje) USD.

Me vendimin Nr.8, date 22.12.2005 te Asamblese se Jashtezakonshme te kesaj shoqerie, eshte vendosur ne menyre unanime nga te gjithë aksioneret e shoqerise, miratimi i shitjes nga Renis Tershana te 3(tre) perqind te pjeses qe ai zoteron ne kapitalin aksioner te shoqerise "BANKA CREDINS" sha e cila perfaqeson 318.424.65 (treqind e tetembedhjetë mije e katerqind e njetzet e kater pike gjashte dhjetë e pese) aksione, me vlere nominale te nje aksioni 1 (nje) USD.

Shitesi, aksioner i shoqerise "BANKA CREDINS" sha, eshte plotesisht dakord dhe i shet me vullnetin e tij te lire dhe te plote blereses, 3(tre) perqind te aksioneve qe ai zoteron ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Nga ana e vet **bleresia**, eshte plotesisht dakord qe te bleje paketen prej 3(tre) perqind te aksioneve nga shitesi qe ai zoteron ne kapitalin e shoqerise "BANKA CREDINS" sha.



CMIMI I SHITJES SE AKSIONEVE DHE MENYRA E PAGESSES.

Vlera e shitjes se aksioneve perkatesisht ne masen prej 3(tre) perqind nga shitesi, do te jete e barabarte me nje vlere prej 318.424.65(treqind e tetembedhjete mije e katerqind e njezet e kater pike gjashte dhjete e pese)USD, vlere kjo me te cilen eshte vleresuar paketa e aksioneve prej 3(tre) perqind te shitura nga ana e aksionerit Renis Tershana, per te cilen eshte rene dakord nga ana e pales blerese.

Pagesa ne shumen e mesiperme eshte bere jashte kesaj zyre noteriale, dhe ne menyren e pageses per te cilen palet kane rene dakord ndermjet tyre.

MENYRA E KALIMIT TE PRONESISE SE AKSIONEVE

Me nenshkrimin e kesaj kontrate shitesi Renis Tershana, aksioner i shoqerise "BANKA CREDINS"sha, humbet pronesine mbi keto aksione, pjese takuese e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise "BANKA CREDINS" sha, duke patur ne te ardhmen vetem 19.67(nentembedhjete pike gjashte dhjete e shtate) perqind te aksioneve.

Bleresia Monika Milo, me nenshkrimin e kesaj kontrate behet pronare edhe e pjeses prej 3(tre) perqind te kapitalit aksioner te shoqerise,.

Keshtu me perfundimin e ketij transakcioni shitje, do te kemi kete gjendje te zoterimit te aksioneve nga ana e paleve ne kete kontrate ne shoqerine "BANKA CREDINS" sha :

Bleresia Monika Milo do te zoteroje 5.93(pese pike nentendhjete e tre) perqind te aksioneve te shoqerise "BANKA CREDINS" sha, nga 2.93 perqind te kapitalit qe ajo zoteronte para kesaj bierje qe perfaqesojne nje vlere totale prej 629.787.65(gjashteqind e njezet e nente mije e shtateqind e tetendhjete e shtate pike gjashtedhjete e pese)USD. Ndersa shitesi Renis Tershana do te zoteroje pas kesaj shitje 19.67(nentembedhjete pike gjashtedhjete e shtate) perqind te aksioneve me nje vlere 2.087.655.35(dymilion e tetendhjete e shtate mije e gjashteqind e pesedhjete e pese pike tridhjete e pese)USD.

KLAUZOLA SHTESE TE KONTRATES

Shpenzimet noteriale dhe ato te depozitimit te akteve ne gjykate, do te perballohen ne menyre te barabarte nga te dyja palet.

Kontrata hartohet ne 5 kopje origjinale, duke patur te gjitha vlere te njejte.Termtat e kontrates pasi u redaktuan prej meje noterit, iu bene te njohura paleve te cilet e nenshkruan ate me deshire dhe vullnetin e tyre te plote ne prezencen time.

SHITESI
Renis Tershana

Renis Tershana

[Signature]

BLERESIA
Monika Milo

Monika Milo

[Signature]

